



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.48

2005

15 qershor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9394 datë 12.5.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për projektin e Spitalit të Përgjithshëm të Kavajës”.....	1717
Ligj nr.9395 datë 12.5.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve”..	1725
Ligj nr.9396 datë 12.5.2005	Për qiranë financiare	1739

LIGJ
Nr.9394, datë 12.5.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
(IDB), PËR PROJEKTIN E SPITALIT TË PËRGJITHSHËM TË KAVAJËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për projektin e Spitalit të Përgjithshëm të Kavajës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4599, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE KREDIE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E SPITALIT TË PËRGJITHSHËM TË KAVAJËS**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më ____/____/1425 H, e cila i përkon ____/____/2004G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur “Kredimarrës”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim referuar si “Banka”).

Në të cilën:

A) Kredimarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë në financimin e kostos së projektit të Spitalit të Përgjithshëm në Kavajë (në vijim të quajtur “Projekti”) sipas përshkrimit në tabelën II të kësaj Marrëveshjeje duke siguruar kredinë e dhënë më poshtë;

B) Një nga qëllimet e Bankës është që të ndihmojë vendet anëtare të saj duke livruar kredi për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu, nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore, i përligjur;

D) Kredimarrësi ka konkluduar ose do të konkludojë me Fondin OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (në vijim të quajtur si Fondi OPEC) një marrëveshje për të ndihmuar në financimin e prokurimit të komponentit të pajisjeve mjekësore dhe furniturave në shumën US\$ 2,242,000/ në termat dhe kushtet e paraqitura në një marrëveshje të bërë ose që do të bëhet ndërmjet Kredimarrësit dhe Fondit OPEC (në vijim të quajtur si Marrëveshja tjetër);

E) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t’i japë Kredimarrësit kredinë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë;

Për këto arsye, palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Seksioni 1.01 Kushtet e përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme, të aplikueshme për kreditë dhe marrëveshje garantuese të Bankës të datës 8.11.1976 (në vijim të quajtur kushtet e përgjithshme), me të njëjtën forcë dhe efekt sikur ato të jenë plotësisht të paraqitura këtu.

Seksioni 1.02 Përkufizimet: Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga kuptimi rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara që jepen si më poshtë vijon:

a) “Datë e vlefshme” do të thotë data në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Kredimarrësit.

b) “Agjencia zbatuese” do të thotë Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë, që është institucioni zbatues përgjegjës për realizimin, drejtimin dhe kontrollin e projektit, ose cildo institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe nga Banka.

c) “Projekti” dhe referime do të thotë projekti dhe pjesë të tij, ashtu siç janë në “pjesë” të tij përshkruar në tabelën II të kësaj Marrëveshjeje.

d) “Dinari islamik/DI”, siç përkufizohet në nenin 4(1) (a) të Marrëveshjes themeluese të Bankës, është njësi për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01 Shuma e kredisë: Banka bie dakord t’i japë Kredimarrësit kredi nga burimet e veta të zakonshme, në një shumë që nuk tejkalon barazvlerën e 3 850 000 DI (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë) vetëm.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga Marrëveshja e kredisë, do të prokurohen me anë të procedurave të përcaktuara nga Banka. Për këtë arsye, Kredimarrësi do t’u përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj Izraelit.

Neni 3

Zhvleftësimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 3.01 Zhvleftësimi: Kredimarrësi do të ripagujë shumën themelore në 25 (njëzet e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë faljeje 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) kështe të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore siç parashikohet në tabelën 1 (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Tarifa e shërbimit:

a) Kredimarrësi do t’i pagujë Bankës një tarifë shërbimi në një shumë të vlerësuar fillimisht në 300 300 DI (treqind mijë e treqind dinarë islamikë), sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën 1 (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga palët në këtë Marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, tek e cila referon nënseksioni 3.02 (a), është veçse një vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë siç është konceptuar këtu. Gjithashtu bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përlllogaritet pas zbatimit të projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të akumulohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03 Vendet e pagesave: Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave janë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 3.04 Pa ndonjë paragjykim për tërësinë e dispozitave të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të gjykohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt:

a) Nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës me të dhënat:

Llogaria nr.59111

Gulf International Bank (UK) Limited

One Knightsbridge, London SW1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

SWIFT CODE: SINTGB2L

b) Nëse kjo pagesë është bërë në paund britanikë, kur banka e mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës me të dhënat:

Llogaria nr.122432 GBP2520 01

Gulf International Bank B.S.C.

75 King William Street, London EC4N7DX

United Kingdom/Britania e Madhe

Tlx. nr.8812889/8813326 GIBANK G

SWIFT CODE: GULFGB2L

c) Nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro, kur banka e mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës me të dhënat:

Llogaria nr.096965 001 51

(Union de Banques Arabes et Françaises (UBAF)/Bashkimi i Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)

92523 Paris, Neuilly Cedex, Francë

Teleks nr.610334 UBAF

SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 4

Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 4.01 Tërheqja: Shuma e kredisë do të tërhiqet nga Kredimarrësi sipas tabelës III dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurave të disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e pranueshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin, për të cilin është rënë dakord sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë: Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshmërisë, ose çdo datë tjetër e mëvonshme siç do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, Kredimarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë të pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Kredimarrësit.

Seksioni 4.03 Data e përfundimit të disbursimit: 30.6.2007 ose një datë mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Kredimarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga shuma e kredisë për qëllime të seksionit 6.03 (c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 4.04 Përdorimi i shumës së kredisë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Kredimarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të projektit të financuar nga Banka.

Neni 5

Zbatimi i projektit

Seksioni 5.01 Kredimarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë projektin dhe të dretojë punimet e tij përmes Agjencisë së Zbatimit me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikën e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me eksperiencë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetin, planifikimet dhe specifikimet lidhur me projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë në mënyrë të detajuar sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi, nga ana e saj, të çdo ndryshim të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specifikimet e projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash lidhur me zbatimin e projektit.

Neni 6

Parakushte shtesë përpara disbursimit nga Banka

Kredimarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, duhet të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet, ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përsa më sipër.

Neni 7 **Dispozita të veçanta**

Seksioni 7.01 Kredimarrësi do të ketë gjendje, sapo t'i kërkohej, të gjitha shumat që përfshijnë sasishtë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e projektit sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveç se kur Banka bie dakord ndryshe, Kredimarrësi do të nënshkruajë të gjitha kontratat që financohen nga kjo kredi për zbatimin e projektit, në përputhje me procedurat e Bankës dhe guidat e Bankës në mënyrën e mëposhtme:

i) Prokurimi i punimeve civile; nëpërmjet tenderit të hapur ndërkombëtar (ICB), i kufizuar vetëm për vendet anëtare të Bankës.

ii) Prokurimi i shërbimeve të konsulencës për projektim, përgatitje të dokumenteve të tenderit dhe supervizion; nëpërmjet përzgjedhjes së konsulentit nga një listë e shkurtër firmash konsulente të vendet anëtare të Bankës.

iii) Prokurimi i auditimit financiar; nëpërmjet një përzgjedhjeje kompetitive lokale të firmave audituese të certifikuara.

iv) Prokurimi i pajisjeve dhe furniturave të zyrës së njësisë së zbatimit të projektit (PMU); nëpërmjet blerjeve direkte lokale, nëse ka një numër të vogël të firmave lokale furnizuese.

Kredimarrësi duhet të kërkojë aprovim paraprak të Bankës për nënshkrimin e ndonjë kontrate, vlera e të cilave tejkalon vlerën ekuivalente të njëqind e pesëdhjetë mijë dinarëve islamikë (150 000 ID).

Seksioni 7.03 Kredimarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre në një mënyrë të detajuar sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Kredimarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e kredisë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në projekt, të dokumentojë ecurinë e projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikatat e konsoliduara të kontabilitetit veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Kredimarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akredituar të Bankës me qëllime të lidhur me projektin, si dhe për të kontrolluar projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistër tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së projektit, mallrave dhe veprimeve, si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Kredimarrësi angazhohet, me qëllim për të çuar më tej dhe zbatuar projektin, të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës në përputhje me rregullat dhe udhëzimet si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi, administratë dhe drejtues të përshtatshëm për ecurinë e nevojshme dhe efikase të veprimtarisë së projektit.

Seksioni 7.07 Kredimarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i kredisë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transit dhe rezeqe të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Kredimarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të projektit dhe do të sigurohen në shuma që janë në përputhje me praktikatat tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e Kredimarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumat e sigurimit në monedhë lehtësisht të shkëmbyeshme.

Seksioni 7.08 Kredimarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohej si e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të, siç kërkohej për realizimin e projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të projektit.

Seksioni 7.09 Kredimarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet kur të jetë e nevojshme për të lejuar institucionin zbatues të realizojë projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim, që mund të ndalojë ose ndërhyjë në zbatimin ose veprimarinë e projektit, ose në përmbushjen e

çdonjërit prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Kredimarrësi si çështje konfidenciale.

Seksioni 7.11 Çdo kosto tejkaluere e kërkuar për projektin do të merret përsipër nga Kredimarrësi. Kredimarrësi do të përballojë gjithashtu të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e lidhura me projektin.

Neni 8 **Raportet**

Seksioni 8.01

a) Kredimarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se objektivat e kredisë do të përmbushen. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar lidhur me gjendjen e përgjithshme të kredisë. Nga ana e Kredimarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Kredimarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Kredimarrësit.

b) Kredimarrësi dhe Banka, në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës palë do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve përkatës përsa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e kredisë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Kredimarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin ose të ndikojë për dorëzimin, në Bankë, të secilit nga raportet e mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë afati tjetër që palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e projektit në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here në mënyrë të detajuar;

ii) Raporte të tjera që Banka në mënyrë të arsyetuar do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së kredisë së disbursuar dhe ecurinë e projektit;

iii) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një date të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Kredimarrësi dhe Banka, Kredimarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të noterizohen sipas vullnetit të lirë të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9 **Vlefshmëria**

Kjo Marrëveshje nuk do të ketë efekte deri sa:

A) 1. Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Kredimarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga të gjitha instancat përkatëse të qeverisjes;

2. Kredimarrësi do të dorëzojë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën që buron nga autoriteti ligjor i Kredimarrësit, duke deklaruar se Marrëveshja e kredisë është autorizuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur në emër të Kredimarrësit. Deklarata do të shprehë se Marrëveshja përbën një detyrim ligjor për Kredimarrësin sipas kushteve të veta.

B) Një letër autorizimi do të nënshkruhet nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion tjetër i autorizuar për këtë qëllim nga ana e Kredimarrësit për bankën qendrore, ose subjektin që ushtron funksionet e një banke qendrore, se pagesa nga Kredimarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje e shumës themelore dhe kështu e tarifës së shërbimit do të kryhen nga banka qendrore, ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara. Një kopje e letrës së autorizimit së bashku me një vërtetim nga banka qendrore, ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, e cila demonstroi se është marrë letra e autorizimit, dhe se do t'i bashkëngjitet udhëzimeve të përfshira në të do t'i dërgohet Bankës nga Kredimarrësi.

C) Paraprakisht të jenë përmbushur të gjitha kushtet, nga ana e Kredimarrësit, për të marrë fondet nën marrëveshjen tjetër.

Neni 10 **Përfundimi i Marrëveshjes për moszbatueshmëri**

Nëse Marrëveshja nuk bëhet efektive deri në shtator 2005, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveçse kur Banka, pas marrjes në konsideratë të të gjitha shkaqeve të vonesës, do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka menjëherë do të njoftojë Kredimarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11 **Dispozita të ndryshme**

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar: Ministri i Financave i Kredimarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Kredimarrësit, për qëllime të seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa: Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Kredimarrësin: - Departamenti i Borxhit të Jashtëm, Ministria e Financave, Republika e Shqipërisë

Tel: 00 355 4 250264

Fax: 00355 4 228494

E mail: mloli@minfin.gov.al

Për Bankën Islamike për Zhvillim: - P.O. Box: 5925, Jeddah 21432, Mbretëria e Arabisë Saudite

Teleks: 601137 ISDB SJ

Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH

Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më sipër.

TABELA I (A) RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE

Shteti:	Republika e Shqipërisë
Projekti:	Spitali i Përgjithshëm i Kavajës
Shuma e kredisë:	DI. 3,850,000/
Periudha e kredisë:	25 vjet
Periudha e faljes:	7 vjet
Tarifa e shërbimit:	300 300 dinarë islamikë

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06. 2012	106,945
2	31.12. 2012	106,944
3	30.06. 2013	106,945
4	31.12. 2013	106,944
5	30.06. 2014	106,945

6	31.12. 2014	106,944
7	30.06. 2015	106,945
8	31.12. 2015	106,944
9	30.06. 2016	106,945
10	31.12. 2016	106,944
11	30.06. 2017	106,945
12	31.12. 2017	106,944
13	30.06. 2018	106,945
14	31.12. 2018	106,944
15	30.06. 2019	106,945
16	31.12. 2019	106,944
17	30.06. 2020	106,945
18	31.12. 2020	106,944
19	30.06. 2021	106,945
20	31.12. 2021	106,944
21	30.06. 2022	106,945
22	31.12. 2022	106,944
23	30.06. 2023	106,945
24	31.12. 2023	106,944
25	30.06. 2024	106,945
26	31.12. 2024	106,944
27	30.06. 2025	106,945
28	31.12. 2025	106,944
29	30.06. 2026	106,945
30	31.12. 2026	106,944
31	30.06. 2027	106,945
32	31.12. 2027	106,944
33	30.06. 2028	106,945
34	31.12. 2028	106,944
35	30.06. 2029	106,945
36	31.12. 2029	106,944
Totali:		3,850,000

TABELA I (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti:	Republika e Shqipërisë
Projekti:	Spitali i Përgjithshëm i Kavajës
Shuma e kredisë:	DI. 3,850,000/
Periudha e kredisë:	25 vjet
Periudha e faljes:	07 vjet
Tarifa e shërbimit:	300 300 dinarë islamikë.

Numër	Datë	Principali (DI)
1	30.06.2005	12,012
2	31.12.2005	24,024
3	30.06.2006	24,024
4	31.12.2006	24,024
5	30.06.2007	24,024
6	31.12.2007	24,024
7	30.06.2008	16,817

8	31.12.2008	16,817
9	30.06.2009	16,817
10	30.12.2009	16,817
11	31.06.2010	16,817
12	30.12.2010	16,817
13	31.06.2011	16,817
14	30.12.2011	16,817
15	31.06.2012	16,817
16	31.12.2012	16,817
Totali:		300,300

TABELA II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është të ndihmojë popullsinë e Kavajës dhe të zonave përreth me një shërbim shëndetësor të përparuar. Kjo do realizohet nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, duke ndërhyrë në ndërtimin të një spitali të ri dhe vendosjes së pajisjeve të nevojshme mjekësore moderne për shërbimet e nevojshme mjekësore. Projekti do të nxjerrë në pah përpjekjet për zhvillim të Qeverisë shqiptare për të siguruar standardet e nevojshme për shërbime shëndetësore të larta për popullsinë, gjë e cila do të shërbejë si një rrjet i konsoliduar që do të ndihmojë edhe në zhvillimin e të gjithë distriktit.

Spitali do të ketë këto departamente, si më poshtë: patologji, pediatri, obsetrikë dhe gjinekologji, mikrokirurgji dhe kirurgji urgjence, si dhe reanimacion.

TABELA III
TËRHEQJA NGA SHUMA E KREDISË

US\$ million

No.	Pershkrimi i komponentëve	Qeveria Shqiptare		OPEC Fund		IDB		Totali i secilit Komponent	
		Amount	%	Amount	%	Amount	%	Amount	%
I	Punime civile (Ndërtim)	0.50	10		0	4.50	90	5.00	100
II	Pajisje mjekësore dhe furniturë		0	2.20	100		0	2.20	100
III	Shërbime konsulence (proj., super.)		0		0	0.50	100	0.50	100
IV	Njësia e menaxhimit të projektit (PMU)	0.09	50		0	0.09	50	0.18	100
V	Shërbime auditimi		0		0	0.05	100	0.05	100

VI	Workshope dhe vizitë familjarizimi në IDB HQ		0		0	0.03	100	0.03	100
	Sub total	0.59	7.41	2.20	27.64	5.17	64.95	7.96	100
	Rezerva si të paparashikuara (10%)	0.06	7.50	0.22	27.50	0.52	65.00	0.80	100
	Totali	0.65	7.42	2.42	27.63	5.69	64.95	8.76	100

LIGJ
Nr.9395, datë 12.5.2005

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR MBROJTJEN E VARIETETEVE TË REJA TË BIMËVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve””, bërë në Gjenevë më 19 mars 1991.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4600, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KONVENTË NDËRKOMBËTARE
PËR MBROJTJEN E VARIETETEVE TË REJA TË BIMËVE E 2 DHJETORIT 1961 E RISHIKUAR NË
GJENEVË MË 10 NËNTOR 1972, 23 DHJETOR 1978 DHE 19 MARS 1991

KAPITULLI I
PERKUFIKIME

Neni 1

Për qëllime të këtij akti :

- i) "Kjo Konventë" nënkupton aktin e tanishëm (1991) të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve;
- ii) “Akti i 1961/1972” nënkupton Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të reja të 2 dhjetorit 1961, siç është amenduar me aktin shtesë të 10 nëntorit 1972;
- iii) Akti i 1978 nënkupton aktin e 23 tetorit 1978, të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve;
- iv) "Seleksionues" nënkupton:
 - personin i cili seleksionon ose zbulon dhe zhvillon një varietet;
 - personin i cili është i punësuar te një person i lartpërmendur ose i cili ka autorizuar punën e këtij të fundit kur e lejojnë ligjet e Palës Kontraktuese, ose pasuesin në titull të personit të parë ose të dytë të sipërpërmendur, sipas rastit.
 - pasuesin në titull të personit të parë ose të dytë të sipërpërmendur, sipas rastit;
- v) “E drejta e seleksionuesit” nënkupton të drejtën e seleksionuesit që garantohet në këtë

Konventë;

vi) "Varietet" nënkupton një grup bimësh në një taksonomi të vetme botanike të rangut më të ulët, grup i cili, pavarësisht nëse një e drejtë për këtë i është garantuar plotësisht një seleksionuesi, mund të jetë:

- përcaktuar nga shprehja e karakteristikave që rezultojnë nga një genotip i dhënë ose kombinim genotipesh;

- i dallueshëm nga ndonjë grup tjetër bimësh me shprehjen e të paktën një prej karakteristikave, dhe

- konsideruar si një njësi lidhur me përshtatshmërinë për të qenë i pandryshuar.

vii) "Palë Kontraktuese" nënkupton një shtet ose një organizatë ndërqeveritare palë me këtë Konventë;

viii) "Territori", në lidhje me një Palë Kontraktuese, nënkupton një territor të këtij shteti kur Pala Kontraktuese është një shtet dhe një territor, në të cilin traktati themelues i kësaj organizate ndërqeveritare zbatohet kur Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare;

ix) "Autoriteti" nënkupton autoritetin referuar në nenin 30 (1) (ii);

x) "Bashkimi" nënkupton Bashkimin për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve themeluar me aktin e 1961, aktin e 1978 dhe këtë Konventë;

xi) "Anëtar i Bashkimit" nënkupton një Shtet Palë në aktin e 1961/1972 ose aktin 1978, ose një Palë Kontraktuese.

KAPITULLI II

DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 2

Detyrimet bazë të Palëve Kontraktuese

Çdo Palë Kontraktuese do të japë dhe mbrojtë të drejtat e seleksionuesit.

Neni 3

Gjinia dhe speciet që mbrohen

1. (Shtetet tashmë anëtare të Bashkimit) - Çdo Palë Kontraktuese e cila është lidhur me aktin e 1961/1972 ose aktin e 1978, do të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente:

i) në datën në të cilën ai bëhet i lidhur nga kjo Konventë për të gjitha gjinitë e bimëve dhe specieve për të cilat zbatohet në atë datë, dispozitat e aktit të 1961/1972 ose aktit të 1978 dhe

ii) jo më vonë se skadimi i periudhës 5 vjet pas kësaj date për të gjitha gjinitë e bimëve dhe specieve.

2. (Anëtarët e rinj të Bashkimit) - Çdo Palë Kontraktuese, e cila nuk është lidhur nga akti i 1961/1972 ose akti i 1978, do të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente:

i) në datën në të cilën ai bëhet i lidhur nga kjo Konventë për të paktën 15 gjini bimësh ose speciesh dhe

ii) jo më vonë nga skadimi i një periudhe 10-vjeçare nga kjo datë për të gjitha gjinitë dhe speciet.

Neni 4

Trajtimi kombëtar

1. (Trajtimi) - Pa paragjykim për të drejtat e specifikuar në këtë Konventë, shtetasit e një Pale Kontraktuese, personat fizikë rezidentë, si dhe personat juridikë që kanë zyrat e tyre të regjistruara në territorin e një Pale Kontraktuese, për aq sa dhënia dhe mbrojtja e të drejtave të seleksionuesit përfshihet, gëzojnë në territorin e çdo Pale Kontraktuese tjetër të njëjtin trajtim siç u është garantuar ose mundet në të ardhmen t'u garantohet me ligj nga kjo Palë Kontraktuese shtetasve të tij, me kusht që këta shtetas, persona fizikë dhe persona juridikë të përputhen me kushtet dhe formalitetet e parashikuara për shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese.

2. (Shtetasit) Për qëllimet e paragrafëve të mëparshëm, "shtetas" nënkupton shtetasit e këtij shteti kur Palë Kontraktuese është një shtet, dhe shtetasit e shteteve të cilët janë palë të kësaj organizate kur Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare.

KAPITULLI III

Neni 5
Kushtet e mbrojtjes

1. (Kriteri për t'u plotësuar) - E drejta e seleksionuesit do të jepet kur varieteti është:
 - i) ri,
 - ii) i dallueshëm,
 - iii) uniform,
 - iv) i qëndrueshëm.
2. (Kushte të tjera) Dhënia e së drejtës seleksionuesit nuk do të jetë subjekt i ndonjë kushti tjetër ose të ndryshëm, me kusht që varieteti të jetë caktuar nga një emërtim në përputhje me dispozitat e nenit 20, që aplikanti është në përputhje me formalitetet e ligjit të Palës Kontraktuese tek autoriteti të cilit është bërë aplikimi dhe që ai paguan tarifën e kërkuar.

Neni 6
Risitë

1. (Kriteri) Varieteti do të gjykohet të jetë i ri në qoftë se në datën e plotësimit të aplikimit për një të drejtë seleksionuese, materiali shumëzues ose materiali i vjelur i varietetit nuk është shitur ose paraqitur para të tjerëve, nga ose me miratim të seleksionuesit, me qëllim shfrytëzimin e varieteteve:
 - i) në territorin e Palës Kontraktuese në të cilën aplikimi është plotësuar më herët sesa një vit përpara asaj date dhe
 - ii) në një territor tjetër nga ai i Palës Kontraktuese në të cilin aplikimi ka qenë plotësuar më herët se 4 vjet para datës në fjalë.
2. (Varietetet e krijuara së fundmi) - Kur një Palë Kontraktuese zbaton këtë Konventë për një bimë-genus ose specie për të cilën ai nuk ka zbatuar më parë këtë Konventë ose një akt të mëparshëm, ai mund ta konsiderojë një varietet të krijuar së fundmi, që ekziston në datën e një shtrirjeje të tillë të mbrojtjes, për të plotësuar kushtin e gjësë së re të përcaktuar në paragrafin (i) edhe kur shitja ose disponimi për të tjerët të përshkruar në këtë paragraf ndodh më herët sesa koha limit e përcaktuar në këtë paragraf.
3. ("Territori" në disa raste) - Për qëllimet e paragrafit (1), të gjitha Palët Kontraktuese të cilat janë shtete anëtare të së njëjtës organizatë ndërqeveritare mund të veprojnë së bashku, kur rregulloret e kësaj organizate e kërkojnë këtë gjë, për të asimiluar akte të bëra në territoret e shteteve anëtare të kësaj organizate në aktet e bëra në territoret e tyre, dhe nëse veprojnë kështu, ato do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 7
Dallueshmëria

Varieteti do të gjykohet të jetë i dallueshëm në qoftë se ai është i dallueshëm qartë nga ndonjë varietet tjetër, ekzistenca e të cilit është një çështje e njohjes së përbashkët në kohën e plotësimit të aplikimit. Në veçanti, plotësimi i një aplikimi për dhënien e së drejtës së seleksionuesit ose për futjen e një varieteti tjetër në një regjistër zyrtar varietetesh, në çdo vend, do të gjykohet të bëjë atë varietet çështje të një njohjeje të përbashkët nga data e aplikimit, me kusht që aplikimi të çojë në dhënien e së drejtës së seleksionuesit ose hyrjen e varietetit tjetër në një regjistër zyrtar varietetesh siç mund të jetë rasti.

Neni 8
Uniformiteti

Varieteti do të gjykohet të jetë uniform nëse, bazuar në ndryshimet e pritura nga tiparet e veçanta pas shumëzimit të tij, ai është në mënyrë të mjaftueshme uniform me karakteristikat e tij respektive.

Neni 9
Stabiliteti

Varieteti do të gjykohet të jetë i qëndrueshëm nëse karakteristikat e tij respektive mbesin të pandryshueshme pas shumëzimit të përsëritur ose në rastin e një cikli të veçantë shumëzimi, në fund të çdo cikli të tillë.

KAPITULLI IV APLIKIMI PËR DHËNIEN E SË DREJTES SË SELEKSIONUESIT

Neni 10

Plotësimi i aplikimeve

1. (Vendi i aplikimit të parë) - Seleksionuesi mund të zgjedhë Palën Kontraktuese me autoritetin e së cilës ai dëshiron të plotësojë aplikimin e tij të parë për një të drejtë seleksionuesi.

2. (Koha e aplikimeve vijuese)- Seleksionuesi mund të aplikojë me autoritetin e Palëve të tjera Kontraktuese për të drejtat e seleksionuesit në pritje të dhënies të së drejtes së seleksionuesit nga autoriteti i Palës Kontraktuese me të cilin aplikimi i parë ishte plotësuar.

3. (Pavarësia e mbrojtjes)- Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të refuzojë të japë një të drejtë seleksionuesi ose të kufizojë zgjatjen e tij në bazë të parimit që mbrojtja për të njëjtin varietet nuk ka qenë zbatuar, ka qenë refuzuar ose ka skaduar në ndonjë shtet tjetër ose organizatë ndërqeveritare.

Neni 11

E drejta e prioritetit

1. (E drejta, periudha e tij) - Çdo seleksionues i cili plotëson në mënyrën e duhur një aplikim për mbrojtjen e një varieteti në një nga Palët Kontraktuese (aplikimi i parë) do të gëzojë të drejtën e prioritetit për një periudhë 12-mujore në rastin e paraqitjes së një aplikimi për dhënie të së drejtës së seleksionuesit për të njëjtin varietet me autoritetin e një Pale tjetër Kontraktuese (aplikimi vijues). Kjo periudhë do të llogaritet nga data e plotësimit të aplikimit të parë. Dita e aplikimit nuk do të jetë përfshirë në periudhën e mëvonshme.

2. (Pretendimi i së drejtës) - Me qëllim që të përfitojë nga e drejta e prioritetit, seleksionuesi do të kërkojë prioritetin e aplikimit të parë në aplikimin vijues. Autoriteti me të cilin aplikimi vijues është plotësuar mund t'i kërkojë seleksionuesit të paraqesë, brenda një periudhe jo më pak se 3-mujore nga data e plotësimit të aplikimit vijues, një kopje të dokumenteve që përbëjnë aplikimin e parë të vërtetuar këto nga autoriteti me të cilin ky aplikim është plotësuar, të dhëna të tjera bindëse se varieteti në fjalë është subjekti i njëjtë i të dy aplikimeve.

3. (Dokumentet dhe materiali) - Seleksionuesit do t'i lejohet një periudhë 2-vjeçare pas skadimit të periudhës së prioritetit ose, nëse aplikimi i parë është refuzuar ose tërhequr një kohë e përshtatshme pas një akti të tillë, për të paraqitur para autoritetit të Palës Kontraktuese me të cilën ai kishte plotësuar aplikimin vijues ndonjë informacion të nevojshëm, dokument ose material të kërkuar për qëllimin e shqyrtimit sipas nenit 12, siç kërkohet nga ligjet e kësaj Pale Kontraktuese.

4. (Ngjarjet e ndodhura gjatë periudhës) - Ngjarjet e ndodhura brenda periudhës që jepen në paragrafin (1), si p.sh. plotësimi i një aplikimi tjetër, botimi ose përdorimi i varietetit që është subjekt i aplikimit të parë, nuk do të përbëjë një bazë për të hedhur poshtë aplikimin vijues. Të tilla ngjarje gjithashtu nuk do të japin shkas për të drejtën e ndonjë pale të tretë.

Neni 12

Shqyrtimi i aplikimit

Çdo vendim për të dhënë të drejtën e seleksionuesit do të kërkojë një shqyrtim për përputhshmërinë me dispozitat e neneve 5-8. Gjatë shqyrtimit, autoriteti mund të rrisë varietetin, të bëjë teste të tjera të nevojshme, të shkaktojë rritjen e varietetit ose kryerjen e testeve të tjera të nevojshme ose të marrë në konsideratë rezultatet e testeve të rritjes ose provave të tjera, të cilat janë bërë tashmë. Për qëllimin e shqyrtimit, autoriteti mund t'i kërkojë seleksionuesit të paraqesë të gjithë informacionin, dokumentet ose materialet e nevojshme.

Neni 13

Mbrojtja e përkohshme

Çdo Palë Kontraktuese do të sigurojë masat e caktuara për të ruajtur interesat e seleksionuesit gjatë periudhës midis plotësimit ose botimit të aplikimit për dhënie e një të drejte seleksionuesi dhe dhënies së kësaj të drejte. Të tilla masa do të kenë efektin që mbajtësi i një të drejte seleksionuesi të ketë të paktën të

drejtën e shpërblimit nga çdo person i cili gjatë periudhës në fjalë ka vepruar në mënyrë të tillë që me t'u dhënë e drejta duhej të kërkohej anëtarizimi i seleksionuesit siç parashikon nenin 14. Një Palë Kontraktuese mund të sigurojë që masa të tilla të kenë efekt në marrëdhënie me personat të cilëve seleksionuesi u ka komunikuar plotësimin e aplikimit.

KAPITULLI V TË DREJTAT E SELEKSIONUESIT

Neni 14

Qëllimi i së drejtës së seleksionuesit

1. (Aktet lidhur me materialin shumëzues) - a) Subjekt i neneve 15 dhe 16, aktet në vijim lidhur me materialin shumëzues të varietetit të mbrojtur do të kërkojnë anëtarizimin e seleksionuesit:

- i) prodhimi ose riprodhimi (shumëzimi);
 - ii) kondicionimi për qëllime shumëzimi;
 - iii) ofrimi për shitje;
 - iv) shitja ose marketingu;
 - v) eksporti;
 - vi) importi;
 - vii) ruajtja për qëllime të përmendura në (i) deri (vi) më sipër.
- b) Seleksionuesi mund të bëjë anëtarizimin e tij subjekt të kushteve dhe kufizimeve.

2. (Aktet lidhur me materialin e vjelur) - Subjekt i neneve 15 dhe 16, aktet e referuara në çështjet (i) deri (vii) të paragrafit (1)(a) lidhur me materialin e vjelur, duke përfshirë bimë të tëra ose pjesë të bimëve të fituara nëpërmjet një përdorimi të paaautorizuar të materialit të shumëzuar të varietetit të mbrojtur, do të kërkojnë anëtarizimin e seleksionuesit, me përjashtim të rasteve kur seleksionuesi ka pasur mundësi të arsyeshme për të ushtruar të drejtën e tij lidhur me këtë material shumëzues.

3. (Aktet lidhur me disa produkte) - Çdo Palë Kontraktuese mund të sigurojë që subjekt i neneve 15 dhe 16, aktet e referuara në çështjet (i) deri (vii) të paragrafit (1)(a) lidhur me produktet e bëra drejtpërdrejt nga materiali i vjelur i varietetit të mbrojtur sipas dispozitave të paragrafit (2) nëpërmjet përdorimit jo të autorizuar të këtij materiali të vjelur, do të kërkojnë anëtarizimin e seleksionuesit, me përjashtim të rasteve kur seleksionuesi ka pasur mundësi të arsyeshme për të ushtruar të drejtën e tij lidhur me këtë material të vjelur.

4. (Akte shitesë të mundshme) – Çdo Palë Kontraktuese mund të sigurojë që subjekt i neneve 15 dhe 16, aktet e ndryshme nga ato të referuara në çështjet (i) deri (vii) të paragrafit (1)(a), do të kërkojnë gjithashtu anëtarizimin e seleksionuesit.

5. (Varietetet esencialisht të derivuara dhe varietetet e tjera) - a) Dispozitat e paragrafit (1) – (4) do të zbatohen gjithashtu në lidhje me:

i) varietete të cilat në mënyrë thelbësore rrjedhin nga varietete të mbrojtura, aty ku varieteti i mbrojtur nuk është në vetvete një varietet që rrjedh në mënyrë thelbësore;

ii) varietete të cilat nuk janë të dallueshme në mënyrë të qartë në përputhje me nenin 7 nga varieteti i mbrojtur dhe

iii) varietete, prodhimi i të cilave kërkon përdorimin e përsëritur të varietetit të mbrojtur.

b) Për qëllimet e nënparagrafit (a)(i), një varietet do të gjykohet të jetë esencialisht i rrjedhur nga një varietet tjetër (varietet fillestar) kur:

i) në mënyrë dominuese rrjedh nga varieteti fillestar ose nga një varietet që është në vetvete mbizotërues i rrjedhur nga varieteti fillestar, por shpreh karakteristikat thelbësore që rezultojnë nga genotipi ose kombinimi i genotipeve të varietetit fillestar;

ii) është në mënyrë të qartë i dallueshëm nga varieteti fillestar dhe

iii) me përjashtim të ndryshimeve që mund të rezultojnë nga akti i derivimit, ai përputhet me varietetin fillestar në shprehjen e karakteristikave thelbësore që rezultojnë nga genotipi ose genotipet e varietetit fillestar.

c) Varietetet që rrjedhin në mënyrë thelbësore mund të përfitohen p.sh. nga seleksionimi i një mutanti natyral ose i induktuar, një varianti somaklonal, një varianti individual nga bimë të një varieteti fillestar ose kryqëzimi apo transformimi me inxhinierinë gjenetike.

Neni 15

Përfundimet për të drejtën e seleksionuesit

1. (Përfundimet detyruese) - E drejta e seleksionuesit nuk duhet të shtrihet për:
 - i) aktet e bëra në rrugë private dhe jo për qëllime tregtare;
 - ii) aktet e bëra për qëllime eksperimentale;
 - iii) aktet e bëra për qëllime seleksionimi të varieteteve të tjera dhe, me përjashtim të rastit kur dispozitat e nenit 14(5) janë të zbatueshme, aktet e referuara në nenin 14 (1) deri (4) për sa i përket varieteteve të tjera të tilla.
2. (Përfundim optimal) - Pavarësisht nga neni 14, çdo Palë Kontraktuese mundet, në limitet e arsyeshme dhe subjekt i ruajtjes së interesave legjitime të seleksionimit, të kufizojë të drejtën e seleksionuesit në lidhje me çfarëdolloj varieteti, me qëllim që t'i lejojë fermerëve përdorimin për qëllim shumëzimi në parcelat e tyre private të prodhimit të vjelur, të marrë nga mbjellja në parcelat e tyre private të varietetit të mbrojtur ose një varieteti të mbuluar nga neni 14 (5)(a)(i) ose (ii).

Neni 16

Përfundimi i së drejtës së seleksionuesit

1. (Përfundimi i së drejtës). – E drejta e seleksionuesit nuk do të shtrihet për aktet që kanë të bëjnë me çdo material të varietetit të mbrojtur ose të një varieteti të mbuluar nga dispozitat e nenit 14(5), të cilat kanë qenë shitur ose tregtuar nga seleksionuesi ose me pëlqimin e tij në territorin e Palës Kontraktuese të interesuar, ose të çdo materiali që rrjedh nga ky material, me përjashtim të rasteve kur akte të tilla:
 - i) përfshijnë shumëzimin e varietetit në fjalë ose
 - ii) përfshijnë një eksport të materialit të varietetit, i cili mundëson shumëzimin e varietetit, në një vend i cili nuk mbron varietetet e gjinisë së bimës ose species së cilës varieteti i përket, me përjashtim të rasteve kur materiali i eksportuar është për qëllime përfundimtare konsumi.
2. (Kuptimi i fjalës "material") - Për qëllimet e paragrafit (1), material nënkupton, në lidhje me një varietet:
 - i) materialin shumëzues të çdo lloji;
 - ii) materialin e vjelur, duke përfshirë bimët e plota dhe pjesët e bimëve, dhe
 - iii) çdo produkt të bërë drejtpërsëdrejti nga materiali i vjelë.
3. (Kuptimi i fjalës "territor" në disa raste) – Për qëllime të paragrafit (1), të gjitha Palët Kontraktuese, të cilat janë shtete anëtare të së njëjtës organizatë ndërqeveritare mund të veprojnë së bashku, kur rregulloret e kësaj organizate e kërkojnë këtë gjë, për të asimiluar akte të bëra në territoret e shteteve anëtare të kësaj organizate në aktet e bëra në territoret e tyre, dhe nëse veprojnë kështu, ato do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 17

Kufizimet për të drejtën e ushtrimit të seleksionuesit

1. (Interesi publik) – Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në këtë Konventë, asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kufizojë ushtrimin e lirë të së drejtës së seleksionuesit për arsye të tjera, përveç atyre të interesit publik.
2. (Shpërblimi i pranueshëm) – Kur një kufizim i tillë ka efektin e anëtarizimit të një pale të tretë për të kryer një akt për të cilën kërkohet anëtarizimi i seleksionuesit, Pala Kontraktuese e interesuar do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që seleksionuesi merr një shpërblim të pranueshëm.

Neni 18

Masat që rregullojnë tregtinë

E drejta e seleksionuesit do të jetë e pavarur nga çdo masë e marrë nga një Palë Kontraktuese, që në çdo rast nuk do të cenojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, për të rregulluar në territorin e saj prodhimin, certifikimin dhe marketingun e materialit të varieteteve ose importin ose eksportin e materialit të tillë.

Neni 19

Afati i së drejtës së seleksionuesit

1. (Periudha e mbrojtjes) - E drejta e seleksionuesit do të garantohet për një periudhë të caktuar kohe.

2. (Periudha minimale) - Kjo periudhë nuk do të jetë më e shkurtër se 20 vjet nga data e dhënies të së drejtës së seleksionuesit. Për pemët dhe vreshtat, kjo periudhë nuk do të jetë më e shkurtër se 25 vjet nga data e dhënies së kësaj të drejte.

KAPITULLI VI EMËRTIMI I VARIETETIT

Neni 20

Emërtimi i varietetit

1. (Caktimi i varieteteve nga emërtimet, përdorimi i emërtimit)

a) Varietetit do t'i jetë caktuar një emërtim i cili do të jetë emërtimi tij gjenetik.

b) Çdo Palë Kontraktuese do të sigurojë që, subjekt i paragrafit (4), asnjë e drejtë në regjistrimin e emërtimit të varietetit nuk do të pengojë përdorimin e lirë të emërtimit në lidhje me varietetin edhe pas skadimit të së drejtës së seleksionuesit.

2. (Karakteristikat e emërtimit) - Emërtimi duhet të mundësojë identifikimin e varietetit. Ai nuk mund të konsistojë vetëm në shifra me përjashtim të rastit kur është vendosur një praktikë e tillë për varietete të caktuara. Ai nuk do të ketë përgjegjësinë për të futur në rrugë të gabuar ose për të shkaktuar konfuzion lidhur me karakteristikat, vlerat, identitetin e varietetit ose identitetin e seleksionuesit. Në veçanti, ai duhet të jetë i ndryshëm nga çdo emërtim i cili përcakton në territorin e çdo Pale Kontraktuese një varietet të njëjtë ose të ngjashëm specijeje.

3. (Regjistrimi i emërtimit) - Emërtimi i varietetit do të paraqitet nga seleksionuesi pranë autoritetit. Në qoftë se rezulton se emërtimi nuk plotëson kërkesat e paragrafit (2), autoriteti do të refuzojë ta regjistrojë dhe do t'i kërkojë seleksionuesit të propozojë një emërtim tjetër brenda një periudhe të përcaktuar. Emërtimi do të regjistrohet nga autoriteti në të njëjtën kohë që i është dhënë e drejta e seleksionuesit.

4. (Të drejtat e mëparshme të personave të tretë) - Të drejtat e mëparshme të personave të tretë nuk do të cenohen. Në qoftë se, për shkak të një të drejte të mëparshme, përdorimi i emërtimit të një varieteti i është ndaluar një personi i cili, në përputhje me dispozitat e paragrafit (7), është i detyruar ta përdorë atë, autoriteti do t'i kërkojë seleksionuesit të paraqesë një tjetër emërtim për varietetin.

5. (Emërtimi i njëjtë në të gjitha Palët Kontraktuese) - Një varietet duhet t'i jetë paraqitur të gjitha Palëve Kontraktuese me të njëjtin emërtim. Autoriteti i çdo Pale Kontraktuese do të regjistrojë emërtimin e paraqitur kështu, me përjashtim të rasteve kur e konsideron emërtimin jo të përshtatshëm në territorin e tij. Në rastin e fundit, ai do t'i kërkojë seleksionuesit të paraqesë emërtimin tjetër.

6. (Informacioni ndërmjet anëtarëve të Palëve Kontraktuese) - Autoriteti i një Pale Kontraktuese do të sigurojë që anëtaritetet e të gjitha Palëve të tjera Kontraktuese janë informuar për çështjet lidhur me emërtimet e varietetit, në veçanti në lidhje me paraqitjen, regjistrimin dhe anulimin e emërtimeve. Çdo anëtaritet mund t'i dërgojë vërejtjet e tij, nëse ka, për regjistrimin e një emërtimi autoritetit të cilit i komunikohet emërtimi.

7. (Detyrimi për të përdorur emërtimin) - Çdo person i cili, brenda territorit të një prej Palëve Kontraktuese, ofron për shitje ose marketing materialin shumëzues të një varieteti të mbrojtur brenda këtij territori, do të jetë i detyruar të përdorë emërtimin e këtij varieteti edhe pas skadimit të së drejtës së seleksionuesit për këtë varietet, me përjashtim të rastit kur, në përputhje me dispozitat e paragrafit (4), të drejtat e mëparshme parandalojnë një përdorim të tillë.

8. (Treguesit e përdorur në lidhje me emërtimet) - Kur një varietet është afruar për shitje ose marketing, ai do të lejohet të shoqërohet me një markë apo emër tregtimi, ose një tregues tjetër të ngjashëm me një emërtim varieteti të regjistruar. Në rast se një tregues është i lidhur kështu, emërtimi duhet të jetë lehtësisht i njohur.

KAPITULLI VII PAVLEFSHMËRIA E TË DREJTËS SË SELEKSIONUESIT

Neni 21

Pavlefshmeria e së drejtës së seleksionuesit

1. (Arsyet e pavlefshmërisë) - Çdo Palë Kontraktuese do të deklarojë një të drejtë seleksionuesi të dhënë prej tij si të pavlefshme dhe pa efekte nëse rezulton se:

i) kushtet e përcaktuara në nenet 6 ose 7 nuk ishin përmbushur në kohën e dhënies të së drejtës së seleksionuesit;

ii) kur dhënia e së drejtës së seleksionuesit ka qenë bazuar në mënyrë thelbësore në informacionin dhe dokumentet e paraqitura nga seleksionuesi, kushtet e përcaktuara në nenet 8 ose 9 nuk ishin përmbushur në kohën e dhënies të së drejtës së seleksionuesit; ose

iii) e drejta e seleksionuesit i është dhënë një personi i cili nuk duhet ta kishte këtë të drejtë, me përjashtim të rasteve kur i është transferuar personit të cilit duhet ta kishte këtë të drejtë.

2. (Përjashtimi i arsyeve të tjera) - Asnjë e drejtë seleksionuesi nuk do të deklarohet i pavlefshëm dhe pa efekte për arsye të tjera përveç atyre të referura në paragrafin (1).

Neni 22

Anulimi i së drejtës së seleksionuesit

1. (Arsyet për anulim) - a) Çdo Palë Kontraktuese mund të anulojë një të drejtë seleksionuesi të dhënë prej tij në rast se është vendosur që kushtet e përcaktuara në nenet 8 ose 9 nuk plotësohen më.

b) Më tej çdo Palë Kontraktuese mund të anulojë një të drejtë seleksionuesi të dhënë prej tij në rast se i është kërkuar kjo dhe brenda një periudhe të përshtatshme:

i) seleksionuesi nuk i siguron autoritetit informacionin, dokumentet ose materialin e gjykuar të domosdoshëm për të verifikuar mbrojtjen e varietetit;

ii) seleksionuesi dështon të paguajë tarifat e pagueshme detyruesisht për të mbajtur të drejtën e tij në fuqi; ose

iii) seleksionuesi nuk propozon një emërtim tjetër të përshtatshëm, kur emërtimi i varietetit është anuluar pas dhënies të së drejtës.

2. (Përjashtimi i arsyeve të tjera) - Asnjë e drejtë seleksionuesi nuk do të anulohet përveç atyre të referura në paragrafin (1).

KAPITULLI VIII

BASHKIMI

Neni 23

Anëtarët

Palët Kontraktuese do të jenë anëtarë të Bashkimit.

Neni 24

Statusi ligjor dhe selia

1. (Personaliteti ligjor)- Bashkimi ka personalitet ligjor.

2. (Kapaciteti ligjor)- Bashkimi gëzon në territorin e secilës Palë Kontraktuese, në përputhje me ligjet e zbatueshme në territorin në fjalë, kapacitetin ligjor të nevojshëm për plotësimin e objektivave të Bashkimit dhe për ushtrimin e funksioneve të tij.

3. (Selia) - Selia e Bashkimit dhe organet e tij të përhershme janë në Gjenevë.

4. (Marrëveshja e selisë) - Bashkimi ka një marrëveshje për selinë e vet me Konfederatën Zvicerane.

Neni 25

Organet

Organet e përhershme të Bashkimit janë Këshilli dhe Zyra e Bashkimit.

Neni 26

Këshilli

1. (Përbërja) - Këshilli do të përbëhet nga përfaqësuesit e anëtarëve të Bashkimit. Çdo anëtar i Bashkimit do të caktojë një përfaqësues në Këshill, si dhe një zëvendës. Përfaqësuesit ose zëvendësit mund të jenë shoqëruar nga ndihmës ose këshilltarë.

2. (Nëpunësit) - Këshilli do të zgjedhë një president dhe një zëvendëspresident të parë ndërmjet anëtarëve të tij. Zëvendëspresidenti i parë do të zërë vendin e presidentit në qoftë se ky nuk është në gjendje të kryejë detyrën. Mandati i Presidentit zgjat për një periudhë 3-vjeçare.

3. (Sesionet) - Këshilli do të mbledhet me thirrjen e Presidentit. Sesi i zakonshëm i Këshillit do të mbahet një herë në vit. Krahës kësaj, Presidenti mund të mbledhë Këshillin edhe në raste të tjera që ai e sheh të arsyeshme; ai gjithashtu e mbledh Këshillin brenda një periudhe 3- mujore, në rast se kërkohet nga një e treta e anëtarëve të Bashkimit.

4. (Vëzhguesit) - Shtetet joanëtare të Bashkimit mund të ftohen si vëzhgues në takimet e Këshillit. Në takime të tilla mund të ftohen edhe vëzhgues dhe ekspertë të tjerë.

5. (Detyrat) - Detyrat e Këshillit do të jenë:

i) të studiojë masat e përbashkëta për të ruajtur interesat dhe për të nxitur zhvillimin e Bashkimit;
ii) të vendosë rregullat e tij të procedurës;
iii) të caktojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe në qoftë se e gjen të arsyeshme një Zëvendëssekretar të Përgjithshëm, si dhe të përcaktojë mandatet e secilit;

iv) të kontrollojë në një raport vjetor aktivitetet e Bashkimit dhe të hartojë programin për punën në të ardhmen;

v) t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të gjitha udhëzimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të Bashkimit;

vi) të vendosë rregullat administrative dhe financiare të Bashkimit;

vii) të kontrollojë dhe të aprovojë buxhetin e Bashkimit dhe të caktojë kontributet e secilit anëtar të Bashkimit;

viii) të kontrollojë dhe të miratojë llogaritë e paraqitura nga Sekretari i Përgjithshëm;

ix) të caktojë datën dhe vendin e konferencave referuar në nenin 38 dhe të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e tyre;

x) në përgjithësi, të marrë të gjitha vendimet e nevojshme për të siguruar funksionimin efikas të Bashkimit.

6. (Votat) – Çdo anëtar i Bashkimit që është një shtet do të ketë një votë në Këshill.

b) Çdo Palë Kontraktuese që është një organizatë ndërqeveritare mundet që, në çështjet brenda kompetencës së vet, të ushtrojë të drejtën për votim të shteteve të tij që janë anëtarë të Bashkimit. Megjithatë një organizatë ndërqeveritare nuk do të ushtrojë të drejtën e votës për shtetet e tij anëtare në qoftë se këto shtete anëtare e ushtrojnë vetë të drejtën e tyre për të votuar dhe anasjelltas.

7. (Shumica) – Çdo vendim i Këshillit do të kërkojë një shumicë të thjeshtë të votave të hedhura, me kusht që çdo vendim i Këshillit sipas paragrafëve (5)(ii), (vi) dhe (vii) dhe neneve 28(3), 29(5)(b) dhe 38(1) të merret me tre të katërtat e votave të hedhura. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

Neni 27

Zyra e Bashkimit

1. (Detyrat dhe drejtimi i zyrës) – Zyra e Bashkimit do të kryejë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e besuara nga Këshilli. Ajo do të jetë nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

2. (Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm) – Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës para Këshillit. Ai do të jetë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit. Ai do t'i paraqesë Këshillit buxhetin e Bashkimit për miratim dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e tij. Ai do të raportojë para Këshillit për administrimin e tij, aktivitetet dhe pozicionin financiar të Bashkimit.

3. (Personeli) – Në bazë dispozitave të nenit 26 (5) (iii), kushtet e kaktimit dhe të punësimit të personelit të nevojshëm për realizimin me sukses të detyrave të zyrës të Bashkimit, do të caktohen në rregulloren administrative dhe financiare.

Neni 28

Gjuhët

1. (Gjuhët e zyrës) – Gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe spanjisht do të përdoren nga zyra e Bashkimit për të kryer detyrat e saj.

2. (Gjuhët në disa takime) – Takimet e Këshillit dhe shqyrtimi i konferencave do të zhvillohen në 4 gjuhë.
3. (Gjuhë të tjera) - Këshilli mund të vendosë përdorimin e gjuhëve të tjera.

Neni 29 Financat

1. (Të ardhurat) - Shpenzimet e Bashkimit do të plotësohen nga:
- i) kontributet vjetore të shteteve anëtare të Bashkimit;
 - ii) pagesat e marra nga shërbimet e kryera;
 - iii) të ardhura të ndryshme.
2. (Kontributet: njësitë)
- a) Pjesa e çdo shteti anëtar të Bashkimit në sasinë e përgjithshme të kontributit vjetor do të përcaktohet duke iu referuar shpenzimeve të përgjithshme për t'u plotësuar nga kontributet e shteteve anëtare të Bashkimit dhe numrit të njërive kontribut të zbatueshem sipas paragrafin (3). Kjo pjesë kontribuese do të jetë llogaritur sipas paragrafit (4).
- b) Numri i njërive kontribut do të shprehet në numra ose fraksione të plota, me kusht që asnjë fraksion nuk do të jetë më i vogël se një e pesta.
3. (Kontributet: pjesa e secilit anëtar)
- a) Numri i njërive kontribut të zbatueshme për çdo anëtar të Bashkimit që është palë e Aktit të vitit 1961/1972 ose Aktit të vitit 1978 në datën në të cilën bëhet e detyrueshme kjo Konvente do të jetë i njëjtë si numri i zbatueshëm për të menjëherë para kësaj date.
- b) Çdo shtet tjetër anëtar i Bashkimit, kur bëhet anëtar, do të duhet të tregojë në një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm numrin e njërive kontribut të zbatueshëm për të.
- c) Çdo shtet anëtar i Bashkimit mundet në çfarëdo kohe të tregojë në një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm një numër njëvish kontribut të ndryshëm nga numri i zbatueshëm për të sipas paragrafin (a) ose (b). Një deklaratë e tillë nëse bëhet gjatë 6 muajve të parë të një viti kalendarik do të marrë efekt nga fillimi i vitit kalendarik të mëparshëm, ndryshe ai do të marrë efekt nga fillimi i vitit të dytë kalendarik që vijon në vitin në të cilën deklarata është bërë.
4. (Kontributet: përllogaritja e pjesëve)
- a) Për çdo periudhë buxhetore, sasia korresponduese e një njësie kontribut do të merret duke pjesëtuar sasinë e përgjithshme të shpenzimeve që priten të bëhen për atë periudhë me kontributet e shteteve anëtare të Bashkimit me totalin e numrit të njërive të aplikueshme për ato shtete anëtare të Bashkimit.
- b) Sasia e kontributit të çdo shteti anëtar të Bashkimit do të merret duke shumëzuar sasinë korresponduese të një njësie kontribut me numrin e njërive kontribut të zbatueshme për atë shtet anëtar të Bashkimit.
5. (Borxhet në kontribute)
- a) Një shtet anëtar i Bashkimit, i cili ka prapambetje në pagesën e kontributeve të tij, nuk mundet, në bazë të nënparagrafit (b), të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar në Këshill, nëse sasia e të prapambeturave të tij është baraz ose kalon sasinë e kontributit që detyrohet të paguajë për vitin e plotë të mëparshëm. Pezullimi i së drejtës për të votuar nuk do të çlirojë një shtet të tillë anëtar të Bashkimit nga detyrimet e tij sipas kësaj Konvente dhe nuk do ta privojë atë nga të drejtat e tjera.
- b) Këshilli mund të lejojë atë shtet anëtar të Bashkimit që të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në rast se Këshilli është i bindur që vonesa në pagesën është rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paevitueshme.
6. (Auditimi i llogarive) - Auditimi i llogarive të Bashkimit do të bëhet nga një shtet anëtar i Bashkimit siç jepet në rregulloren administrative dhe financiare. Një shtet i tillë anëtar do të caktohet nga Këshilli, pas dhënies së pëlqimit prej tij.
7. (Kontributet e organizatave ndërqeveritare)
- Çdo Palë Kontraktuese, e cila është një organizatë ndërqeveritare, nuk do të jetë e detyruar të paguajë kontribute. Në rast se ajo zgjedh që të paguajë kontribute, dispozitat e paragrafit (1) deri (4) do të zbatohen në përputhje me to.

KAPITULLI IX ZBATIMI I KONVENTËS; MARRËVESHJET E TJERA

Neni 30

Zbatimi i Konventës

1. (Masat e zbatimit) - Çdo Palë Kontraktuese do të miratojë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente, në veçanti ajo:

i) do të sigurojë rregullimet e përshtatshme ligjore për forcimin efektiv të të drejtave të seleksionuesit;

ii) do të mbajë një autoritet të besuar me detyrën e dhënies të së drejtës së seleksionuesit ose t'ia besojë këtë detyrë një autoriteti të mbrojtur nga një Palë tjetër Kontraktuese;

iii) do të sigurojë që publiku është informuar nëpërmjet botimit të rregullt të informacionit që ka të bëjë me:

- zbatimin për dhënien e të drejtave të seleksionuesit dhe

- propozimin dhe miratimin e emërtimeve.

2. (Përputhja e ligjeve) - Duhet të jetë e kuptueshme që, me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, sipas rastit, çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare do të jetë në një pozitë, sipas ligjeve të veta, t'i japë efekt dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 31

Marrëdhëniet midis Palëve Kontraktuese dhe shteteve të lidhura me akte të mëparshme

1. (Marrëdhëniet midis shteteve të lidhura nga kjo Konventë) - Midis shteteve anëtare të Bashkimit, të cilat janë të lidhura nga kjo Konventë, dhe çdo akti të mëparshëm, vetëm kjo Konventë do të zbatohet.

2. (Marrëdhëniet e mundshme me shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë) - Çdo shtet anëtar i Bashkimit që nuk është palë në këtë Konventë, mund të deklarojë në një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, që në marrëdhëniet e tij me çdo shtet anëtar të Bashkimit palë vetëm në këtë Konventë, ai do të zbatojë aktin më të fundit të lidhur. Gjithashtu nga skadimi një muaj pas datës së një njoftimi të tillë dhe deri sa shteti anëtar i Bashkimit që bën deklaratën bëhet palë në këtë Konventë, ky anëtar i Bashkimit do të zbatojë aktin e fundit për të cilin ai ka detyrim në marrëdhëniet e tij me çdo anëtar të palës në këtë Konventë, ndërkohë që ky i fundit do të zbatojë këtë Konventë për sa i përket të mëparshmes.

Neni 32

Marrëveshjet e posaçme

Anëtarët e Bashkimit rezervojnë të drejtën për të përfunduar midis tyre marrëveshje të posaçme për mbrojtjen e varieteteve, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

KAPITULLI X

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33

Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim për çdo shtet që është anëtar i Bashkimit në datën e miratimit të saj. Ajo do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 mars 1992.

Neni 34

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. (Shtetet dhe disa organizata ndërqeveritare)

a) Çdo shtet mundet të bëhet palë e kësaj Konvente mbështetur në këtë nen.

b) Çdo organizatë ndërqeveritare të bëhet palë e kësaj Konvente mbështetur në këtë nen, në qoftë se ka:

i) kompetencë në lidhje me çështjet që udhëhiqen nga kjo Konventë;

ii) legjislacionin e tij që siguron dhënien dhe mbrojtjen e së drejtës së seleksionuesit në mënyrë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare;

iii) qenë siç duhet i autorizuar në përputhje me procedurat e tij të brendshme për të hyrë në këtë

Konventë.

2. (Instrumenti përkatës detyrues) - Çdo shtet i cili ka nënshkruar këtë Konventë do të bëhet palë e kësaj Konvente duke depozituar një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi të kësaj Konvente. Çdo shtet që nuk e ka nënshkruar këtë Konventë, si dhe çdo organizatë ndërqeveritare do të bëhen palë e kësaj Konvente duke depozituar një instrument aderimi në këtë Konventë. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. (Këshilla e Këshillit) - Çdo shtet i cili nuk është anëtar i Bashkimit dhe çdo organizatë ndërqeveritare, para depozitimit të instrumentit të saj të aderimit, do t'i kërkojë Këshillit ta këshillojë në lidhje me përputhshmërinë ligjit të saj me dispozitat e kësaj Konvente. Në qoftë se vendimi që përfshin këshillën është pozitiv, instrumenti i aderimit mund të depozitohet.

Neni 35

Rezervat

1. (Parimi) - Subjekt i paragrafit (2) rezervat për këtë Konventë nuk lejohen.

2. (Përfshirja e mundshme) - (a) Pavarësisht nga dispozitat e nenit 3(1), çdo shtet i cili, në kohën kur bëhet palë e kësaj Konvente, është një palë e Aktit të 1978 dhe i cili, për sa i përket varieteteve të riprodhuara joseksualisht, siguron mbrojtjen e një titulli pronësie industriale tjetër nga ajo e së drejtës së seleksionuesit, do të ketë të drejtën për të vazhduar ta bëjë këtë pa e zbatuar këtë Konventë për këto varietete.

(b) Çdo shtet që përdor këtë të drejtë në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, sipas rastit, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për këtë. I njëjti shtet mundet në çdo kohë të tërheqë këtë njoftim.

Neni 36

Komunikimet lidhur me legjislacionin dhe gjinitë e speciet e mbrojtura; informacioni që publikohet

1. (Komunikimi fillestar) - Kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit pranimi, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, siç mund të jetë rasti, çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për:

i) legjislacionin e vet që udhëheq të drejtat e seleksionuesit, dhe

ii) listën e gjinive të bimëve dhe specieve për të cilat, në datën në të cilën ai është bërë palë në këtë Konventë, ai do të zbatojë dispozitat e kësaj Konvente.

2. (Komunikimi i ndryshimeve) - Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm për:

i) çdo ndryshim në legjislacionin e tij të të drejtave të seleksionuesit dhe

ii) çdo shtrirje të zbatimit të kësaj Konvente për gjini bimësh dhe speciesh shtesë.

3. (Botimi i informacionit) - Sekretari i Përgjithshëm në bazë të komunikimeve të marra nga çdo Palë Kontraktuese e interesuar, do të botojë informacionin për:

i) legjislacionin e të drejtave të seleksionuesit dhe ndonjë ndryshim në këtë legjislacion, dhe

ii) listën e gjinive dhe specieve të bimëve referuar në paragrafin (1) (ii) dhe ndonjë shtrirje referuar në paragrafin (2) (ii).

Neni 37

Hyrja në fuqi; përfundimi i akteve të mëparshme

1. (Hyrja fillestare në fuqi) - Kjo Konventë do të hyjë në fuqi një muaj pasi 5 shtete të kenë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, siç mund të jetë rasti, me kusht që të paktën 3 nga këto instrumente të jenë depozituar nga Shtetet Palë të Aktit të 1961/1972 ose Aktit të 1978.

2. (Hyrja në fuqi në vijim) - Çdo shtet që nuk mbulohet nga paragrafi (1) ose ndonjë organizatë ndërqeveritare, do të lidhet nga kjo Konventë një muaj pas datës në të cilën ai ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit pranimi, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, siç mund të jetë rasti.

3. (Mbyllja e aktit 1978) - Asnjë instrument aderimi në Aktin e 1978 nuk mund të depozitohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas paragrafit (1), me përjashtim të rastit kur çdo shtet, që në përputhje me praktikën e vendosura të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara konsiderohet një vend në

zhvillim, mund të depozitojë një instrument të tillë deri më 31 dhjetor 1995 dhe që çdo shtet tjetër mund të depozitojë një instrument të tillë deri më 31 dhjetor 1993 edhe në rast se kjo Konventë hyn në fuqi përpara kësaj date.

Neni 38

Rishikimi i Konventës

1. (Konferenca) - Kjo Konventë mund të shqyrtohet nga konferenca e anëtarëve të Bashkimit. Thirrja e Konferencës do të vendoset nga Këshilli.

2. (Kuorumi dhe shumica) - Punimet e Konferencës do të jenë të vlefshme vetëm nëse të paktën gjysma e shteteve anëtare të Bashkimit janë përfaqësuar në të. Një shumicë prej tre të katërtave të shteteve anëtare të Bashkimit të pranishëm që votojnë në Konferencë do të kërkohen për miratimin e çfarëdo rishikimi.

Neni 39

Denoncimi

1. (Njoftimi) - Çdo Palë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë në njoftimin drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm menjëherë do të njoftojë të gjithë anëtarët e Bashkimit për marrjen e këtij njoftimi.

2. (Aktet e mëparshme) - Njoftimi i denoncimit të kësaj Konvente do të gjykohej gjithashtu si njoftimi i denoncimit të çdo akti të mëparshëm me të cilin Pala Kontraktuese që denoncon këtë Konventë është lidhur.

3. (Data efektive) - Denoncimi do të marrë efekt në fund të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. (Të drejtat e fituara) - Denoncimi nuk do të cenojë ndonjë të drejtë të fituar për shkak të kësaj Konvente ose çdo akti të mëparshëm para datës në të cilën denoncimi bëhet efektiv.

Neni 40

Ruajtja e të drejtave ekzistuese

Kjo Konventë nuk do të kufizojë të drejtat e seleksionuesit sipas ligjeve të Palëve Kontraktuese ose për arsye të ndonjë akti të mëparshëm, ose ndonjë marrëveshjeje tjetër si kjo e përfunduar midis anëtarëve të Bashkimit.

Neni 41

Tekstet origjinale dhe zyrtare të Konventës

1. (Origjinali) - Kjo Konventë do të nënshkruhet në një origjinal të vetëm në gjuhët anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht, ku teksti frëngjisht do të mbizotërojë në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet teksteve të ndryshme. Origjinali do të jetë depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. (Tekstet zyrtare) - Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, do të vulosë tekstet zyrtare të kësaj Konvente në gjuhët arabe, holandeze, italiane, japoneze dhe spanjolle dhe gjuhë të tjera që Këshilli mund të përcaktojë.

Neni 42

Funksionet depozitare

1. (Transmetimi i kopjeve) - Sekretari i Përgjithshëm do t'u transmetojë kopje të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha shteteve dhe organizatave ndërqeveritare, të cilët ishin përfaqësuar në konferencën diplomatike që miratoi këtë Konventë dhe, me kërkesën e tyre, çdo shtet tjetër ose organizatë ndërqeveritare.

2. (Regjistrimi) - Sekretari i Përgjithshëm do të regjistrojë këtë Konventë në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

LIGJ
Nr.9396, datë 12.5.2005

PËR QIRANË FINANCIARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Afat i qirasë” është afati fillestar i përcaktuar në kontratën e qirasë financiare, gjatë së cilës qiramarrësi ka të drejtë të mbajë dhe të përdorë sendin.
2. “Çmim blerjeje” është shuma e paracaktuar, që qiramarrësi paguan pas mbarimit të afatit të kontratës së qirasë, kur vendos ta blejë sendin.
3. “Defekte të sendit” janë të metat fizike, të shfaqura ose të fshehura, të sendit.
4. “Defekte ligjore” janë pengesat e krijuara, që pengojnë ose cenojnë gëzimin e qetë e të plotë të sendit nga qiramarrësi gjatë tërë afatit të qirasë financiare.
5. “Dorëzanës” ka kuptimin që i jepet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
6. “Furnizues” është personi fizik ose juridik që, në bazë të kontratës së furnizimit, i shet qiradhënësit sendin që i jepet me qira qiramarrësit.
7. “Këste pagese” janë pagesat e çmimit të shitjes, që paguhet nga blerësi në rastin e shitjes me rezervë të sendit.
8. “Kontratë furnizimi” është kontrata, që lidh furnizuesi i sendit me qiradhënësin për sendin e përzgjedhur nga qiramarrësi, në përputhje me përcaktimet e qiramarrësit dhe me kushtet e miratuara prej tij, me anë të së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi atë send.
9. “Kontratë qiraje” është kontrata e qirasë financiare, që lidhet ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit për përdorimin e sendit për një afat, sa pjesa më e madhe e afatit të konsumimit të sendit, përkundrejt pagesave periodike, shuma e të cilave është sa vlera reale në treg e sendit, por që arrin të mbulojë investimin e qiradhënësit dhe të sigurojë një fitim mbi investimin.
10. “Pagesa qiraje” janë pagesat periodike, që bën qiramarrësi gjatë afatit të kontratës së qirasë financiare, sipas kushteve të përcaktuara në të.
11. “Qira financiare” është marrëdhënia juridike, sipas së cilës qiradhënësi i blen furnizuesit një send të përzgjedhur nga qiramarrësi pranë furnizuesit dhe ia jep atë qiramarrësit për ta përdorur për një afat të caktuar, kundrejt një çmimi të caktuar në kontratë dhe, me mbarimin e afatit të kontratës, qiramarrësi mund ta blejë sendin, të vazhdojë ta mbajë me qira për një afat tjetër ose t’ia kthejë atë qiradhënësit.
12. “Qiradhënësi” është personi juridik, që ka dhe ruan të drejtën e pronësisë mbi sendin dhe që i jep qiramarrësit të drejtën të mbajë dhe të përdorë sendin gjatë afatit të kontratës së qirasë, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.
13. “Qiramarrës” është personi fizik ose juridik, që mund të fitojë të drejtën e pronësisë pasi ka mbajtur në përdorim sendin gjatë tërë afatit të kontratës së qirasë dhe pasi ka shlyer të gjitha pagesat e qirasë dhe çmimin përfundimtar të blerjes.
14. “Qira financiare e drejtpërdrejtë” është qiraja, sipas së cilës qiradhënësi i jep qiramarrësit një send që ka në pronësi, për ta përdorur për një afat të caktuar, në mbarim të të cilit qiramarrësi ka të drejtë ta blejë sendin, duke paguar një çmim të caktuar, ta zgjasë afatin e kontratës për mbajtjen me qira të sendit ose t’ia kthejë atë qiradhënësit.

15. “Rimarrje” është riposidimi i sendit, përfshirë riposidimin jashtëgjyqësor të tij, në rast mospërmbyshjeje të detyrimeve nga qiramarrësi, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

16. “Send” është çdo send, i luajtshëm ose i paluajtshëm, objekt i qirasë financiare.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj trajton qiranë financiare, të drejtat dhe detyrimet e Palëve në kontratën përkatëse dhe rregullon marrëdhëniet që lindin nga dhënia me qira financiare e sendeve, të luajtshme e të paluajtshme e që dallohen nga veçoritë e mëposhtme:

a) sendi përzgjidhet nga vetë qiramarrësi, në pavarësi të plotë prej qiradhënësit;

b) sendi blihet nga qiradhënësi ose, sipas rastit, ndërtohet me mjetet e tij financiare, për t’ia dhënë qiramarrësit me qira financiare, sipas kontratës së lidhur ose që do të lidhin e për të cilën furnizuesi ka dijeni të plotë;

c) qiraja është në formë pagesash, të cilat përllëgoariten duke vlerësuar edhe normën e amortizimit të sendit, të një pjese ose të pjesëve thelbësore të tij;

ç) në mbarim të afatit të kontratës, qiramarrësi ka të drejtë ta blejë sendin, duke paguar një shumë simbolike, të paracaktuar nga Palët ose të caktuar në çastin e ushtrimit të të drejtës së blerjes, ta përtërijë kontratën për një afat tjetër, kundrejt pagesës së një qiraje më të ulët se ajo fillestare, ose t’ia kthejë sendin qiradhënësit.

2. Ky ligj trajton edhe qiranë financiare të drejtpërdrejtë, ku qiradhënësi është vetë pronar i sendit ose ndërtues i tij dhe ia jep sendin me qira drejtpërdrejt qiramarrësit.

3. Në dallim nga qiraja financiare me furnizues, në qiranë financiare të drejtpërdrejtë:

a) qiradhënësi, krahas sendit, i ofron qiramarrësit edhe shërbime ndihmëse e mirëmbajtjeje;

b) sendet që jepen me qira janë, kryesisht, të një lloji;

c) qiramarrësi ka më tepër liri ta zgjidhë kontratën para afatit, me njoftim paraprak.

KREU II

PALET NË QIRANË FINANCIARE

Neni 3

Përkufizimi dhe marrëdhëniet e Palëve në qiranë financiare

1. Palët në qiranë financiare janë qiradhënësi, qiramarrësi dhe furnizuesi.

2. Qiradhënësi, që nuk është institucion financiar ose bankë, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër përveçse atë të qirasë financiare, i cili, në çastin e regjistrimit si person juridik në gjykatë, duhet të ketë një kapital jo më të vogël se 20 000 000 lekë.

3. Qiramarrësi është pala, që i kërkon qiradhënësit t’i blejë sendin e përzgjedhur prej tij të furnizuesi dhe t’ia japë qiramarrësit me qira financiare.

4. Detyrimet e qiramarrësit mund të merren përsipër nga dorëzanës, me anë të kontratës së dorëzanisë, të lidhur ndërmjet qiramarrësit dhe dorëzanësit.

5. Furnizuesi është pala që ka në pronësi, prodhon ose ndërton sendin, sipas kërkesës së qiramarrësit dhe më pas ia shet atë qiradhënësit, përkundrejt pagimit të çmimit të shitjes së sendit nga qiradhënësi.

Neni 4

Subjektet që kryejnë veprimtari bankare e financiare

Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fushën bankare ose financiare, mund të kryejnë veprimtari qiraje financiare vetëm nëse e drejta për të kryer veprimtari qiraje financiare përfshihet shprehimisht në licencën ose në lejen përkatëse.

Neni 5

Natyra tregtare e kontratës së qirasë financiare

Në rastet kur qiramarrësi në kontratën e qirasë financiare është person fizik, i paregjistruar për zhvillim veprimtarie tregtare, kontrata e qirasë financiare vlerësohet jotregtare dhe u nënshtrohet rregullave të përgjithshme të kontratave.

KREU III AFATI I QIRASË FINANCIARE

Neni 6

Afati minimal i qirasë financiare të sendeve të luajtshme

1. Sendet e luajtshme, me afat konsumimi deri në pesë vjet, jepen me qira financiare për një afat të paktën një vit, që llogaritet nga data e pranimi të sendit nga qiramarrësi deri në datën e shlyerjes së pagesës së fundit.

2. Sendet e luajtshme, me afat konsumimi mbi pesë vjet, mund të jepen me qira financiare për një afat të paktën dyvjeçar, që llogaritet nga data e pranimi të sendit nga qiramarrësi deri në datën e shlyerjes së pagesës së fundit.

Neni 7

Afati minimal i qirasë financiare të sendeve të paluajtshme

Sendet e paluajtshme mund të jepen me qira financiare për një afat minimal të paktën trevjeçar, që llogaritet nga data e pranimi të qiramarrësi deri në datën e shlyerjes së pagesës së fundit.

KREU IV JURIDIKSIONI

Neni 8

Qiraja financiare vendase dhe qiraja financiare ndërkombëtare

1. Qiraja financiare është vendase kur sendi mbahet me qira në Republikën e Shqipërisë dhe si qiradhënësi, ashtu edhe qiramarrësi kanë banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Qiraja financiare është ndërkombëtare kur si qiradhënësi, edhe qiramarrësi, ose njëri prej tyre, nuk kanë selinë ose banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë. Qiraja financiare në këtë rast rregullohet nga e drejta ndërkombëtare e qirasë financiare ose, sipas rastit, nga marrëveshjet dyPalëshe, ku Republika e Shqipërisë është Palë.

KREU V PARIME BAZË NË MARRËDHËNIET E QIRASË FINANCIARE

Neni 9

E drejta e pronësisë

1. Sendi i jepet qiramarrësit për ta mbajtur dhe përdorur për një afat të caktuar, ndërsa pronësia e tij mbetet e qiradhënësit dhe i kalon qiramarrësit, në rast se qiramarrësi vendos të ushtrojë të drejtën e blerjes, siç parashikohet në kontratën e qirasë financiare.

2. Kur kontrata zgjidhet para afatit për faj të qiramarrësit, pagesat e qirasë nuk trajtohen si këste blerjeje dhe shlyerja e tyre nuk krijon të drejta pronësie të qiramarrësit mbi sendin. Nga ana tjetër, qiramarrësi e humbet të drejtën e mbajtjes dhe të përdorimit të mëtejshëm të sendit, i cili rimerret nga qiradhënësi.

Neni 10

Mbajtja e rreziqeve

Kur nuk parashikohet ndryshe në kontratën e qirasë financiare, me pranimin e sendit nga qiramarrësi, të gjitha rreziqet që lidhen me sendin, përfshirë dëmtimin, humbjen rastësore, vjedhjen ose

humbjen e parakohshme të përdorshmërisë së tij, i kalojnë qiramarrësit.

KREU VI KONTRATA E QIRASË FINANCIARE

Neni 11 Forma e kontratës

Kontrata e qirasë lidhet me shkrim dhe bëhet me akt noterial, kur kontrata përmban kushtet për rimarrjen jashtëgjyqësore të sendit, në rastet e zgjidhjes së kontratës para afatit, për faj të qiramarrësit.

Neni 12 Kushtet bazë të kontratës

- Kontrata e qirasë duhet të përmbajë, ndër të tjera:
- a) përshkrimin e sendit, në mënyrë të tillë, që e bën të mundur dallimin e tij;
 - b) afatin fillestar dhe të drejtën e qiramarrësit për ta përtërirë atë për një afat tjetër ose disa afate të tjera, por përtëritja bëhet kur sendi është në gjendje të plotësojë nevojat, për të cilat është marrë me qira;
 - c) të drejtën e blerjes së sendit nga qiramarrësi dhe çmimin përkatës ose formulën e caktimit të çmimit;
 - ç) numrin dhe shumën e pagesave të qirasë ose formulën e llogaritjes së tyre;
 - d) rastet e mospranimin të sendit nga qiramarrësi;
 - dh) rastet e zgjidhjes së kontratës dhe procedurat e rimarrjes së sendit nga qiradhënësi;
 - e) detyrimin e palëve për mbulimin e shpenzimeve dhe barrën e administrimit, përfshirë mbështetjen teknike, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të shërbimeve ndihmëse, që lidhen me përdorshmërinë e sendit;
 - ë) përgjegjësinë ndaj palëve të treta;
 - f) detyrimin për sigurimin e sendit;
 - g) detyrimet e Palëve, në rastin e të metave të sendit.

KREU VII TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE NË QIRANË FINANCIARE

Neni 13 Njoftimi i furnizuesit

1. Qiradhënësi detyrohet ta njoftojë me shkrim furnizuesin se e blen sendin për t'ia dhënë me qira qiramarrësit, sipas kontratës së qirasë, që qiradhënësi ka lidhur me qiramarrësin.
2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të dërgohet përpara ose në çastin e nënshkrimit të kontratës së furnizimit.

Neni 14 Përzgjedhja e sendit dhe kufizimi i përgjegjësisë së qiradhënësit

1. Qiramarrësi ka të drejtën e përzgjedhjes së sendit, si edhe të furnizuesit, kur ka të tillë, pa u mbështetur në aftësitë dhe gjykimin e qiradhënësit. Afatet dhe kushtet e furnizimit të sendit pranohen nga qiramarrësi në masën që nuk cenojnë interesat e tij.
2. Kur qiramarrësi ka miratuar përmbajtjen e kontratës së furnizimit ndërmjet qiradhënësit dhe furnizuesit, sipas së cilës qiradhënësi fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin, ndryshimet e mëvonshme të kushteve të kontratës së furnizimit nuk mund të cenojnë të drejtat e qiramarrësit, me përjashtim të rasteve kur ai i ka pranuar vetë këto ndryshime.
3. Me pranimin e sendit, detyrimet e qiradhënësit, në lidhje me sendin dhe pretendimet e të tretëve pushojnë, me përjashtim të pretendimeve, që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet e qiradhënësit.
4. Qiradhënësi nuk mban përgjegjësi ndaj qiramarrësit e as ndaj të tretëve në raste vdekjeje, dëmsh trupore ose dëmsh jopasurore, që vijnë prej sendit, as si qiradhënësi e as si pronar i sendit.

Neni 15
Dorëzimi i sendit

1. Në rast se kontrata e qirasë nuk përcakton se dorëzimi kryhet drejtpërdrejt nga qiradhënësi, sendi ose pjesët ndihmëse apo shtesat e tij, në qoftë se ka, mund t'i jepen qiramarrësit nga furnizuesi.

2. Sendi duhet të dorëzohet në gjendje të mirë në kohën, në vendin dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratën e furnizimit.

Neni 16
Pranimi i sendit

1. Qiramarrësi ka të drejtë të çmojë nëse sendi i furnizuar përputhet ose jo me përshkrimin e bërë në kontratën e qirasë dhe, kur sendi përputhet me përshkrimin, nuk mund të mos e pranojë atë.

2. Kur sendi nuk përputhet me përshkrimin në kontratën e qirasë ose kur furnizuesi apo qiradhënësi nuk e dorëzojnë sendin, e dorëzojnë me vonesë ose e dorëzojnë pa respektuar kushtet e kontratës së qirasë, qiramarrësi ka të drejtë:

- a) të mos e pranojë;
- b) të zgjidhë kontratën e qirasë;
- c) të mbajë pezull pagesat e qirasë, të përcaktuara në kontratën e qirasë, derisa të kryhet dorëzimi i sendit, në përputhje me kushtet e kontratës së qirasë;
- ç) të dëmshpërblehet për humbjet, që mund të shkaktohen nga mospërbushja e detyrimeve kontraktore prej qiradhënësit, sipas rastit, edhe duke ia zbritur vlerën e dëmit ose të një pjese të tij pagesave të ardhshme të qirasë.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, kontrata e qirasë vazhdon efektet, kur qiradhënësi ia dorëzon qiramarrësit sendin pa vonesa të mëtejshme.

Neni 17
Furnizimi i sendit pjesë-pjesë

1. Kur kontrata e qirasë parashikon furnizimin e sendit pjesë-pjesë dhe furnizimi i njëres pjesë nuk kryhet sipas kushteve të kontratës, qiramarrësi i cakton një afat të ri qiradhënësit për të kryer furnizimin.

2. Në rast se qiradhënësi nuk kryen furnizimin brenda afatit të ri, të caktuar nga qiramarrësi, qiramarrësi ka të drejtë të mos pranojë asnjërën nga pjesët e sendit ose të pranojë njëërën apo disa pjesë me vlerë tregtare të tij e të mos pranojë pjesën tjetër. Në këtë rast detyrohet të paguajë qiranë përkatëse për çdo send të pranuar, duke zbritur shpenzimet e kryera prej tij, për shkak të mospërbushjes në kohë të detyrimit nga qiradhënësi.

Neni 18
Pranimi i prezumuar i sendit

1. Qiramarrësi prezumohet se e ka pranuar sendin dhe nuk mund të kundërshtojë furnizimin e sendit e as të zgjidhë kontratën e qirasë kur, pasi ka pasur kohë e mundësi të mjaftueshme për ta kontrolluar sendin e furnizuar:

a) me deklaratë me shkrim ose me veprimet e tij në lidhje me sendin, i ka dhënë të kuptojë qiradhënësit se sendi i furnizuar është në përputhje me kushtet e kontratës ose se e ka pranuar sendin, pavarësisht nga mospërputhjet;

b) nuk ka njoftuar mospranimin e sendit brenda afateve të caktuara nga Palët, pas zbulimit të mospërputhjes.

2. Pranimi i prezumuar i sendit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk shteron mjetet e tjera ligjore, që qiramarrësi gëzon nga kontrata ose ligji në rastet e mospërbushjes së detyrimeve nga qiradhënësi.

3. Kur qiramarrësi e ka pranuar sendin, nisur nga premtimi dhe garancia që jep qiradhënësi se ai do ta përmbushë detyrimin, por nuk e përmbush atë brenda një afati të arsyeshëm, qiramarrësi mund ta shfuqizojë pranimin, duke njoftuar me shkrim qiradhënësin.

Neni 19

Përgjegjësia e furnizuesit ndaj qiramarrësit

1. Detyrimet e furnizuesit ndaj qiradhënësit në kontratën e furnizimit, përfshirë çdo garanci, të shprehur ose të nënkuptuar, që furnizuesi i jep qiradhënësit, janë detyrime edhe kundrejt qiramarrësit, si të ishte edhe ky Palë në atë kontratë, por brenda caqeve të interesave të qiramarrësit, në kuadër të raportit të qirasë financiare me kontratën e furnizimit dhe pa cenuar kushtet e kontratës së furnizimit, si dhe të gjitha të drejtat e pretendimet e furnizuesit, sipas kontratës së furnizimit.

2. Përfshirja e qiramarrësit në pikën 1 të këtij neni bëhet vetëm për të mbrojtur interesat e tij në kontratën e furnizimit dhe në asnjë rast nuk duhet interpretuar sikur në atë kontratë qiramarrësi merr përsipër edhe detyrime ose përgjegjësi.

3. Pavarësisht nga përmbajtja e dispozitave të pikës 1 të këtij neni:

a) furnizuesi nuk mund të mbajë përgjegjësi të dyfishtë ndaj qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të njëjtën kohë, për të njëjtën mospërmbushje të kushteve të kontratës së furnizimit ose mospërmbushje të detyrimeve në garancitë e shprehura apo të nënkuptuara, që furnizuesi i jep qiradhënësit;

b) qiramarrësi nuk merr përsipër detyrime në kontratën e furnizimit;

c) qiramarrësi nuk ka të drejtë të zgjidhë ose të kërkojë shfuqizimin e kontratës së furnizimit dhe as të kërkojë uljen e çmimit të shitjes së sendit, të përcaktuar në kontratën e furnizimit, pa pëlqimin e qiradhënësit.

Neni 20

Pranimi i detyrueshëm i sendit nga qiramarrësi

Qiramarrësi është i detyruar ta pranojë sendin e dhënë nga qiradhënësi kur e ka pranuar atë nisur nga premtimi i furnizuesit se do të ndreqte çdo mospërputhje të sendit të kërkuar me atë të furnizuar.

Neni 21

Ndryshimi i kontratës së furnizimit

1. Të drejtat që gëzon qiramarrësi në kontratën e furnizimit nuk preken në rast se kontrata e furnizimit ndryshohet ose zgjidhet pa pëlqimin e qiramarrësit.

2. Ndryshimi ose zgjidhja e kontratës së furnizimit pa pëlqimin e qiramarrësit vlerësohet zgjidhje e njëanshme e kontratës së qirasë nga qiradhënësi.

Neni 22

Përgjegjësia e përbashkët dhe e ndarë e qiradhënësit dhe e furnizuesit

Kur furnizuesi zgjidhet nga qiradhënësi ose kur qiradhënësi ka ndërhyrë në procesin e përzgjedhjes së sendit ose të furnizuesit dhe kur sendi nuk i është dorëzuar qiramarrësit sipas kontratës së qirasë, apo ka shkelje të tjera të rënda të kontratës, qiradhënësi dhe furnizuesi janë përgjegjës si bashkërisht, edhe individualisht kundrejt qiramarrësit.

Neni 23

Përgjegjësia e qiradhënësit për cenimin e gëzimit të sendit dhe të metat e sendit

1. Qiradhënësi detyrohet t'i sigurojë qiramarrësit gëzimin e plotë e të qetë të sendit. Ai është përgjegjës për pretendimet e të tretëve mbi sendin, të cilat kundërshtojnë, cenojnë ose kufizojnë gëzimin e plotë të sendit prej qiramarrësit, ndërkohë që qiramarrësi nuk ka dijeni dhe e ka pranuar sendin pa pasur dijeni për këto pretendime. Është i pavlefshëm çdo kusht i kontratës së qirasë, i cili shmang ose kufizon përgjegjësinë e qiradhënësit për defektet ligjore të sendit.

2. Qiramarrësi njofton qiradhënësin për çdo pretendim të të tretëve mbi sendin, të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe i kërkon çlirimin e sendit nga të tilla pretendime, brenda një afati të arsyeshëm.

3. Kur nuk ka pengesë në kontratë, qiramarrësi mund ta zgjidhë atë në rast se humbet gëzimin e sendit dhe qiradhënësi nuk përmbush kërkesën e pikës 2 të këtij neni.

4. Kur zvogëlohet ose kufizohet gëzimi plotë i sendit nga qiramarrësi dhe qiradhënësi nuk përmbush kërkesën e qiramarrësit, sipas pikës 2 të këtij neni, atëherë qiramarrësi ka të drejtë ta zgjidhë

kontratën, në rast se objekti i saj nuk mund të përmbushet siç duhet, ose ka të drejtë të kërkojë uljen përpjesëtimore të pagesave të qirasë.

5. Në rastet e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, qiramarrësi nuk ka të drejtën e zhdëmtimit, kur e ka pranuar sendin ose kur i zvogëlohet apo i kufizohet gëzimi i plotë i sendit, ndërkohë që kishte dijeni për to në kohën lidhjes së kontratës së qirasë.

Neni 24

Mjetet ligjore të qiramarrësit kundrejt furnizuesit

Kur furnizuesi nuk përmbush detyrimet ndaj qiramarrësit, të parashikuara në këtë ligj, qiramarrësi ka të drejtë të zhdëmtohet nga furnizuesi për dëmet, që shkaktohen nga mospërmbushja e detyrimeve.

Neni 25

Përdorimi dhe mirëmbajtja e sendit

1. Kur në kontratën e qirasë nuk përcaktohet ndryshe, qiramarrësi detyrohet ta përdorë e ta mirëmbajë sendin me shpenzimet e veta.

2. Qiramarrësi përgjigjet për humbjet e shkaktuara nga përdorimi i sendit në kundërshtim me kontratën ose në kundërshtim me qëllimin e qirasë, pavarësisht nëse e ka përdorur vetë, një person i autorizuar prej tij apo një person tjetër, me miratimin e mëvonshëm të tij.

Neni 26

Kontrolli nga qiradhënësi gjatë afatit të qirasë

Qiradhënësi ka të drejtë të ushtrojë kontroll për të parë nëse sendi përdoret e mirëmbahet në mënyrën e duhur ose dhe të shqyrtojë dokumentacionin financiar të qiramarrësit për qiranë financiare, gjatë gjithë afatit të qirasë.

KREU VIII

ZGJIDHJA E KONTRATËS SË QIRASË

Neni 27

Zgjidhja normale e kontratës së qirasë

Kontrata e qirasë quhet e zgjidhur kur:

- a) mbaron afati i caktuar në kontratë;
- b) falimenton qiradhënësi, furnizuesi ose qiramarrësi;
- c) sendi shkatërrohet ose humbet;
- ç) palët vendosin me marrëveshje zgjidhjen e saj.

Neni 28

Zgjidhja e kontratës nga qiradhënësi

1. Qiradhënësi mund ta zgjidhë kontratën e qirasë para afatit, kur qiramarrësi nuk shlyen pagesën e parë të qirasë, brenda afatit të caktuar në kontratë.

2. Qiradhënësi mund ta zgjidhë kontratën e qirasë ose t'i kërkojë qiramarrësit të parapaguajë shumën e plotë të papaguar të pagesave, bashkë me kamatëvonesat, edhe kur qiramarrësi shlyen pagesën e parë, por pas saj nuk shlyen në kohë një ose disa pagesa të tjera të qirasë, shumën e përgjithshme e të cilave arrin në njëzet për qind të vlerës së qirasë.

3. Qiradhënësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e qirasë, kur qiramarrësi nuk përmbush ndonjërin nga kushtet e kontratës së qirasë dhe mospërmbushja vazhdon njëzet ditë pasi ai ka marrë njoftim me shkrim nga qiradhënësi, për të respektuar kushtet e kontratës.

4. Qiradhënësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e qirasë, kur dorëzani i paraqitur nga qiramarrësi është në gjendje paafësie paguese ose ka falimentuar dhe qiramarrësi nuk arrin ta zëvendësojë atë me një dorëzanës tjetër, të pranueshëm për qiradhënësin, brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa me shkrim e qiradhënësit, për kryerjen e këtij zëvendësimi.

5. Qiradhënësi, që kërkon ta zgjidhë kontratën e qirasë për shkaqet e parashtruara në pikat 1 deri 4

të këtij neni, detyrohet të njoftojë qiramarrësin. Njoftimi i dërgohet qiramarrësit brenda shtatë ditëve kalendarike para fillimit të procedurës së rimarrjes së sendit, duke i dhënë mundësi qiramarrësit të shlyejë pagesën e qirasë ose të përmbushë ndonjë detyrim tjetër.

Neni 29

Zgjidhja e kontratës nga qiramarrësi

1. Qiramarrësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e qirasë para pranimit të sendit, kur ky nuk është furnizuar në përputhje me kontratën ose, pas pranimit të sendit, për mospërmbushjen e detyrimeve nga qiradhënësi.

2. Qiramarrësi ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e qirasë pas pranimit të sendit, kur qiradhënësi nuk garanton gëzimin e plotë të sendit nga qiramarrësi, me kusht që:

a) mospërmbushja të ketë sjellë humbjen e të gjitha përfitimeve, që qiramarrësi ka sipas kontratës së qirasë;

b) qiramarrësi të ketë njoftuar me shkrim qiradhënësin për mospërmbushjen dhe ajo nuk është ndrequr brenda periudhës së përcaktuar në njoftim.

KREU IX

PASOJAT E ZGJIDHJES SË KONTRATËS

Neni 30

E drejta e rimarrjes së sendit

1. Me zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë, në rastet e parashikuara nga ky ligj, qiradhënësi ka të drejtë:

a) ta rimarrë sendin;

b) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjithë shumës së papaguar të qirasë;

c) të zhdëmtohet për dëmet e pësuar;

ç) të marrë të gjitha shpenzimet shtesë, të bëra për shkak të mospagimit të detyrimeve nga qiramarrësi, duke zbritur shumën e vlerës së tregut të sendit të rimarrë.

2. Çdo shumë e marrë nga qiradhënësi në tejkalim të shumës, që del nga mbledhja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i paguhet qiramarrësit.

Neni 31

Rimarrja jashtëgjyqësore e sendit

1. Kur qiradhënësi kërkon marrjen e sendit me procedura jashtëgjyqësore, për mospërmbushje të detyrimeve të kontratës nga qiramarrësi, siç parashikohet nga ky ligj, Palët mund të nënshkruajnë aktin e rimarrjes, krahas kontratës së qirasë financiare, si shtojcë dhe pjesë përbërëse e kontratës. Në këto raste kontrata e qirasë bëhet me akt noterial.

2. Procedura e rimarrjes jashtëgjyqësore të sendit bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e qirasë.

Neni 32

Procedura e rimarrjes së sendit me anë të sekuestrimit

1. Kontrata e qirasë financiare është titull ekzekutiv dhe vihet në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pas lëshimit të urdhrit përkatës të ekzekutimit nga gjykata kompetente, e cila shprehet brenda pesë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. Gjykata, që nxjerr urdhrin e ekzekutimit, përcakton edhe veprimet që duhet të kryejë përbaruesi për sekuestrimin e sendit dhe dorëzimin e tij qiradhënësit ose personit të autorizuar prej tij.

3. Urdhri i njoftohet qiramarrësit brenda 5 ditëve nga data e lëshimit dhe nëse qiramarrësi nuk e dorëzon sendin vullnetarisht, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, përbaruesi gjyqësor vendos menjëherë

sekuestron mbi të.

Neni 33

Mbrojtja e palëve që kanë lidhje me sendin

1. Çdo person, të cilit i cenohen të drejtat nga sekuestrimi i sendit të përshkruar në nenin 32 të këtij ligji, mund t'i kërkojë gjykatës kompetente:

a) të pezullojë procedurat, kur provohet se qiramarrësi nuk është në rrethana të mospërbushjes së detyrimeve të kontratës e as të shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të urdhërojë rikthimin e sendit të qiramarrësi;

b) t'i kërkojë qiradhënësit të zbatojë një ose disa kërkesa procedurale të këtij ligji;

c) të heqë detyrimin e çdo personi për të zbatuar një ose disa kërkesa procedurale të këtij ligji, kur ky detyrim është i panevojshëm ose nuk ka shkaqe për të cilat mund të kërkohej;

ç) t'i kërkojë një personi të rimbursojë shpenzimet e kryera nga një person tjetër për procedura gjyqësore, të nisura pa pasur asnjë bazë.

2. Gjykata nxjerr vendimin përkatës brenda dhjetë ditëve nga data e depozitimit në gjykatë të kërkesës, sipas parashikimeve të këtij neni.

KREU X

DISPOZITA SHITESË

Neni 34

Nënqiraja financiare

1. Qiramarrësi ka të drejtë t'u japë me nënqira financiare të tretëve tërë sendin ose pjesë të tij vetëm me pëlqimin me shkrim të qiradhënësit. Në rast se qiramarrësi lidh kontratë nënqiraje pa pëlqimin e qiradhënësit, ky i fundit ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e qirasë dhe të kërkojë edhe zhdëmtim.

2. Edhe kur qiradhënësi jep pëlqimin për dhënien me nënqira financiare të sendit, qiramarrësi vazhdon të mbetet përgjegjës kundrejt qiradhënësit.

3. Në rast mospagimi të qiramarrësit ose të nënqiramarrësit, kur sendi mbahet me nënqira financiare nga nënqiramarrësi, qiradhënësi ka të drejtë ta rimarrë sendin drejtpërdrejt prej nënqiramarrësit, sipas procedurave të njëjta, që zbatohen kur qiradhënësi e rimerr sendin prej qiramarrësit.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për kontratën e nënqirasë në lidhje me qiramarrësin, nënqiramarrësin dhe furnizuesin njëjloj si në rastin e marrëdhënieve ndërmjet qiradhënësit, qiramarrësit dhe furnizuesit.

5. Afati i kontratës së nënqirasë nuk mund të jetë më i gjatë se ai i kontratës së qirasë.

Neni 35

Kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve të kontratës së qirasë nga qiradhënësi

1. Qiradhënësi mund t'i kalojë të tretëve të drejtat që ka mbi sendin, sipas kontratës së qirasë, pa miratimin e qiramarrësit.

2. Kalimi i të drejtave nuk e çliron qiradhënësin nga asnjë detyrim i përcaktuar në kontratën e qirasë dhe as nuk e ndryshon natyrën e kontratës së qirasë.

3. Kontrata e qirasë mund të parashikojë heqjen dorë të qiramarrësit nga mjetet ligjore kundër zëvendësuesit të qiradhënësit.

Neni 36

Ndryshimet dhe përmirësimet e sendit

1. Kur nuk parashikohet ndryshe në kontratën e qirasë, përmirësimet e veçanta që qiramarrësi mund t'i bëjë sendit mbeten në pronësi të qiramarrësit.

2. Kur qiramarrësi i bën përmirësime sendit, me shpenzimet e veta dhe me miratimin me shkrim të qiradhënësit, dhe përmirësimet nuk mund të shkëputen prej sendit pa e dëmtuar atë, atëherë qiramarrësi ka të drejtë të paguhet për vlerën e këtyre përmirësimeve, nëse sendi i kthehet qiradhënësit pas zgjidhjes së kontratës së qirasë.

Neni 37

Shtesat

Pronësia, që ka qiradhënësi mbi sende të luajshmë, të cilat janë dhënë me qira financiare para ose në kohën që ato ngjiten apo shkrihen me sende të paluajshmë ose sende të tjera të luajshmë, nuk cenohet nga pretendime pronësie të personave, të cilët kanë tituj të caktuar mbi sendet e paluajshmë apo sendet e tjera të luajshmë, që ngjiten ose shkrihen me sendet e dhëna me qira.

Neni 38

Sigurimi

1. Kontrata e qirasë duhet të parashikojë sigurimin e sendit nga çdo lloj dëmtimi, që ka lidhje me rrezikun e shkatërrimit, humbjes, vjedhjes, prishjes ose vjetërimit të parakohshëm.

2. Në mungesë të parashikimeve në kontratë, detyrimi për sigurimin e sendit rëndon mbi qiramarrësin.

Neni 39

Falimentimi i qiramarrësit

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, nëse deklarohet falimentimi i qiramarrësit, sendi nuk përfshihet në pasuritë e falimentuara, as në garancinë e përgjithshme për kreditorët, por i kthehet qiradhënësit.

2. Megjithatë, kur pagesat e qirasë financiare janë shlyer në përputhje me kontratën e qirasë, administratori i falimentimit mund t’i kërkojë qiradhënësit, me një letër rekomande, brenda tridhjetë ditëve nga vendimi i gjykatës që shpall falimentimin, konfirmimin nëse ai dëshiron të vazhdojë kontratën e qirasë.

3. Në rast të procedurave të likuidimit të qiramarrësit, kur ky është person juridik, si në rastet e likuidimit të detyrueshëm, ashtu edhe vullnetar, por kur ai nuk bëhet me shkrim dhe pa cenuar të drejtat e qiradhënësit, të përcaktuara në kontratën e qirasë, sendi i kthehet qiradhënësit.

Neni 40

Falimentimi i qiradhënësit

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, në rast deklarimi të falimentimit të qiradhënësit, qiramarrësi ka të drejtë ta vazhdojë kontratën e qirasë.

2. Kur për qiradhënësin ka filluar procedura e likuidimit, pavarësisht nëse likuidimi është i detyrueshëm ose vullnetar, qiramarrësi ka të drejtë ta vazhdojë kontratën e qirasë me pronarin e ri të sendit ose të ripaguajë të gjithë shumën e papaguar të qirasë financiare dhe të fitojë pronësinë mbi sendin, në mbarim të afatit të qirasë.

KREU XI

KONTRATA E QIRASË FINANCIARE TË DREJTPËRDREJTË

Neni 41

Qiraja financiare e drejtpërdrejtë

Kontrata e qirasë financiare e drejtpërdrejtë, ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit, nuk ka Palë ndërmjetëse dhe është e njëjtë, në formë e në përmbajtje, me atë të qirasë financiare.

KREU XII

REGJISTRIMI I KONTRATAVE TË QIRASË FINANCIARE

Neni 42

Regjistrimi i sendeve të paluajshmë

Kontratat e qirasë financiare të sendeve të paluajshmë, që përmbajnë kushte për fitimin e pronësisë mbi to ose mundësinë e blerjes së këtyre sendeve nga qiramarrësi, regjistrohen në përputhje me kërkesat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajshmë”.

Neni 43

Regjistrimi i kontratave të qirasë financiare të sendeve të luajtshme

1. Kontratat e qirasë financiare të sendeve të luajtshme, sipas këtij ligji, regjistrohen në regjistrin e barrëve siguruese, në përputhje me ligjin “Për barrët siguruese”.

2. Efektet e regjistrimit ose të mosregjistrimit të kontratës së qirasë financiare mbi pronësinë ose të drejtat e tjera të qiradhënësit dhe të Palëve të treta rregullohen nga ligji “Për barrët siguruese”.

KREU XIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 44

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për rregulloren e veprimit të shoqërive, që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.

Neni 45 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4601, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 15.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë